



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Studime Britanike 2

Titullari/pedagogu i lëndës: Prof.Asoc.Dr. Iris KLOSI
Ngarkesa: 4 kredite (40 orë), (20 orë leksione, 20 orë seminare)
Viti akademik : 2024-2025, Viti III, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Gjuhë Angleze, “Studime Britanike dhe Amerikane “
Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës: iris.klosi@unitir.edu.al
Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT –së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri të thelluara mbi kulturën dhe institucionet bashkëkohore britanike. Të zhvillojë aftësitë analitike dhe kritike për të eksploruar kontekste sociale, politike dhe kulturore të Mbretërisë së Bashkuar. Të nxisë të kuptuarit e temave moderne si identiteti kombëtar, emigracioni, media dhe kultura popullore në Britani.

Objektivat specifike lëndore :

1. Të zgjerojë njohuritë e studentëve përmes qasjeve krahasuese dhe ndërdisiplinore në analizën e kulturës britanike.
2. Të udhëheqë studentët në studimin e marrëdhënieve midis kontekstit historik dhe zhvillimeve bashkëkohore sociale dhe kulturore.
3. Të lejojë eksplorimin dhe interpretimin e fenomeneve kulturore nëpërmjet analizës së materialeve të shkruara dhe vizuale (tekste, artikuj, dokumentarë).

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë tekstet dhe fenomenet kulturore britanike duke i vendosur në kontekst historik dhe shoqëror të saktë.
2. Do të identifikojnë çështje kyçe të kulturës bashkëkohore britanike dhe do të diskutojnë në mënyrë të argumentuar rreth tyre, si me gojë ashtu edhe me shkrim.
3. Do të jenë në gjendje të hartojnë ese origjinale dhe të shfaqin mendim të pavarur mbi temat e trajtuara, duke përdorur terminologji përkatëse akademike.